

# Kushtet e përgjithshme të biznesit për anëtarët e myWorld

Versioni: Shkurt 2021

## Hyrje

- A.** myWorld International Limited, kompani e regjistruar në 40 Bank Street, London E14 5NR, Mbretëri e Bashkuar, operon në të gjithë botën një **Benefit Program** cili u mundëson klientëve pjesëmarrës ("Anëtarët") të marrin përfitime ("Benefits") duke blerë mallra, shërbime, udhëtime, etj. ("Blerjet") në platformën online myWorld, tek Kompanitë Partnere online dhe Kompanitë Partnere lokale (së bashku "myworld dhe Kompanitë Partnere"). myWorld International Limited përdor në vendet ku operon, filialin përkatës ose partnerët përkatës të bashkëpunimit për procesimin dhe operimin e **Benefit Program**.
- B.** Në Republikën e Shqipërisë Anëtarët janë të regjistruar në myWorld Albania Shpk, Bulevardi Bajram Curri, Galeria ETC Business Centre, Kati i 13-të, 1000 Tiranë, Shqipëri ("myWorld"), duke u mundësuar atyre të blejnë mallra, shërbime, udhëtime etj nga myWorld dhe Kompanitë Partnere, dhe, në këtë mënyrë, të gjenerojnë Benefits në Benefit Program.
- C.** Çdo kusht dhe afat që parashikohet në Kushtet dhe Afatet e Përgjithshme të Biznesit mund të gjendet në fund të Kushteve dhe Afateve të Përgjithshme të Biznesit në Shtojcën 1. Kushtet në këto Kushte dhe Afate të Përgjithshme të Biznesit janë të detyrueshme.

## 1. Objekti i Kontratës

Në përputhje me Kushtet dhe Afatet e Përgjithshme të Biznesit, një Anëtar ka të drejtë të marrë pjesë në Benefit Program dhe të marrë Benefits e shoqëruara. Anëtarët mund të blejnë tek myWorld dhe Kompanitë Partnere. Regjistrimi dhe pjesëmarrja në Benefit Program është falas për Anëtarin.

## 2. Baza e Kontratës

- 2.1** Duke u regjistruar, ju bëheni Anëtar i myWorld dhe merrni një numër identifikimi personal, të pa transferueshëm ("ID-ja e Anëtarit"). Kjo ju jep të drejtën të merrni pjesë në Benefit Program.
- 2.2** Anëtarit garanton që informacioni që ai i ka dhënë myWorld është i saktë dhe do të dëmshpërblejë plotësisht e do të mbajë të pacënura të drejtat e myWorld në rast të informacioneve të pavërteta me qëllim . Një Anëtar merr përsipër të informojë myWorld pa vonesë të panevojshme për çdo ndryshim në të dhënat personale të dhëna në kohën e regjistrimit (në veçanti adresën, adresën e email, detajet e logarisë bankare, numrin e telefonit, etj.).
- 2.3** Secili individ ose person juridik lejohet të regjistrohet vetëm një herë (d.m.th. vetëm një ID e Anëtarit). Për regjistrimin, një Anëtar duhet të japë një adresë shtëpie ose biznesi (zyrë e regjistruar). Nëse një Anëtar përpiqet të regjistrohet më shumë se një herë me qëllim për të marrë Benefits shtesë, myWorld rezervon të drejtën të përfundojë marrëdhënien kontraktuale për arsye të justifikuar dhe të revokojë çdo Benefit të marrë në këtë mënyrë. Nëse një Anëtar regjistrohet më shumë se një herë, ID-ja më e fundit e Anëtarit do të fshihet. Çdo Benefit do të revokohet.

## 3. Benefit Program

- 3.1** Duke kryer një Blerje nga myWorld dhe një Kompani Partnere, Anëtarit merr Benefits në përputhje me Kushtet dhe Afatet e Përgjithshme të Biznesit. Benefits dhe kushtet e tyre përkatëse përshkruhen më hollësisht në Klauzolën 5.
- 3.2** Për tu mundësuar dhënien e Benefits Anëtarëve për blerjet e tyre, myWorld lidh kontrata me Kompanitë Partnere. Kompanitë Partnere aktuale dhe Benefits e lidhura përkatëse janë renditur online në [www.myworld.com](http://www.myworld.com).
- 3.3** Anëtarit ka opsionet e mëposhtme për të regjistruar blerjet e tij: myWorld Card, aplikacioni myWorld ose në Zonën e Anëtarëve të Regjistruar në faqen e internetit të myWorld
- 3.4** Kompania Partnere i dërgon të gjitha të dhënat e Blerjes dhe / ose të faturimit në myWorld për llogaritjen e Benefits që rezultojnë.

## 4. Online Shopping

- 4.1** Anëtarit mund të futet në [www.myworld.com](http://www.myworld.com) ose përmes aplikacionit myWorld duke përdorur të dhënat e tij të hyrjes dhe të zgjedhë në online shop që dëshiron në myWorld ose një Kompani Partnere ose të kryejë Blerjen direkt nga online shop. Blerja në Kompaninë Partnere online mund të regjistrohet vetëm nëse sistemi i Anëtarit lejon cookies gjatë procesit të Blerjes dhe nuk përdor bllokues reklamash ose bllokues skedarësh. Anëtarët mund të mësojnë më shumë rreth Blerjeve nga Kompanitë Partnere në internet në FAQs në [www.myworld.com](http://www.myworld.com)
- 4.2** Anëtarët kanë të drejtë të anulojnë Blerjet online ose të heqin dorë nga kontrata e konsumatorit pa arsye brenda 14 ditëve nga posedimi fizik për Blerjet e mallrave dhe nga lidhja e kontratës për Blerjet e shërbimeve. Benefits që rezultojnë nga Blerjet online kërkojnë, në përputhje me Klauzolën 5.3, që periudha e anulimit sipas rregullave ligjore duhet të ketë përfunduar dhe Anëtarit nuk duhet të ketë anuluar Blerjen.

- 4.3** *Anëtari* ka të drejtën e *Benefits*-eve vetëm për ato *Blerje* në online shop të *Kompanive Partnere* të cilët janë të listuara në [www.myworld.com](http://www.myworld.com) sipas vendit ku ndodhet adresa e shtëpisë, dorëzimit ose adresa e biznesit të *Anëtarit* (sipas regjistrimit).
- 4.4** *myWorld* nuk ka asnjë ndikim në modelimin e online shop (të ndërlidhura) të *Kompanive Partnere* dhe nuk është përgjegjës në asnjë lloj forme për këto faqe. *myWorld* distancohet shprehimisht nga çdo përmbajtje në këto faqe në internet që mund të jenë të paligjshme ose në kundërshtim me normat e zakonshme.
- 5. Benefits**
- 5.1** *Benefits* përkatëse të dhëna janë të shënuara në [www.myworld.com](http://www.myworld.com). *Anëtari* këshillohet të kontrollojë faqen e internetit të *myWorld* rregullisht lidhur me statusin e kushteve për *Kompaninë Partnere* përkatëse. *myWorld* rezervon të drejtën për të ndryshuar *Benefits* e dhëna për secilën prej *Kompanive Partnere* në çdo kohë. Kushtet që zbatohen në kohën kur *Anëtari* ka kryer pagesën e plotë të *Blerjes* do të përdoren për të llogaritur *Benefits* që i takojnë *Anëtarit*.
- 5.2** *myWorld* rezervon të drejtën të ndryshojë parimet e përcaktuara këtu në lidhje me promovimet të veçanta. *myWorld* është i interesuar t'u ofrojë *Anëtarëve* të vet zgjedhjen më të madhe të mundshme të mundësive të blerjeve të *Kompanisë Partnere* dhe të dakordësorjve ulje thelbësore me *Kompaninë Partnere* në mënyrë që t'u ofrojë *Benefits* reale *Anëtarëve*. Nëse dakordësohen kushte të tjera me një *Kompani Partnere* në formën e promovimeve speciale (siç mund të jetë rasti me *Blerjet* atipike si kontratat e telefonisë celulare ose planifikimet e udhëtimitve), *myWorld* do t'i referohet këtyre kushteve veçmas në [www.myworld.com](http://www.myworld.com).
- 5.3** Në mënyrë që *Benefits* të kreditohen, *Anëtari* duhet të kryejë pagesën e plotë të *Blerjes i, pas së cilës* *Anëtari* nuk ka më asnjë të drejtë për të anuluar *Blerjen* përveç se me arsye, pra në veçanti, çdo periudhë ekzistuese e heqjes dorë duhet të ketë përfunduar. Nëse këto kërkesa plotësohen, *Kompania Partnere* do të konfirmojë dhe raportojë *Blerjen* tek *myWorld*. *Benefits* nga *Blerjet* e kryera që janë raportuar në *myWorld* deri në orën 23:00 pasdite të së dielës nga *Kompania Partnere*, do t'i kreditohen *Anëtarit*. *myWorld* i detyron *Kompaninë Partnere* të raportojnë jo më vonë se brenda tre muajsh nga data në të cilën kërkesat sipas kësaj Klauzole janë përbushur. Kreditimi i *Benefits* tek *Anëtari* do të jetë i mundur vetëm pasi *Kompania Partnere* ta ketë raportuar atë në *myWorld*.
- 5.4** Nëse *Anëtari* bën *Blerje* nga *Kompaninë Partnere* jashtë vendit (lokalisht ose në internet), *Cashback* së pari duhet të tregohet në llogarinë e pagesës në valutën përkatëse të huaj. Pas konfirmimit të *Blerjes* nga *Kompania Partnere*, shumat në *Zonën e Anëtarit të Regjistruar* përkatës do të konvertohet automatikisht në monedhën e vendit të *Anëtarit* në përputhje me kursin përkatës të këmbimit të Bankës së Shqipërisë ose të ndonjë banke tjetër relevante për datën kur pagesa është marrë nga *Kompania Partnere*. Klauzola 4.3 do të mbetet e pandryshuar, d.m.th. *Benefits* do të jepen vetëm për *Blerjet* jashtë vendit (për shembull *Kompaninë Partnere* online) që janë të listuara në faqen e internetit të *myWorld* për *Anëtarin* përkatës.
- 5.5** *Benefits* bazohen në kushtet e rena dakord në kontratën midis *myWorld* dhe *Kompanisë Partnere* përkatëse dhe ato për këtë arsye mund të ndryshojnë. *Benefits* mund të konsistojnë në *Cashback*, *Shopping Points* ose promovime të tjera.
- 5.5.1** *Cashback*: *Anëtari* mund të marrë *Cashback* për *Blerjet* e rezervuara në *Benefit Program*, ku përqindja përkatëse për produkt ose për *Kompani Partnere* shfaqet në [www.myworld.com](http://www.myworld.com). *Blerjet* individuale mund të përjashtohen nga dhënia e *Cashback*. *Cashback* përfaqëson një zbritje në *Blerjen* përkatëse dhe jepet në formën e një krediti blerjeje për përdorim të mëtejshëm brenda grupit *myWorld*.
- 5.5.2** *Shopping Points*: *Anëtari* mund të marrë *Shopping Points* për *Blerjet* e rezervuara në *Benefit Program* ku numri përkatës për produkt ose për *Blerje* të *Kompania Partnere* tregohet në [www.myworld.com](http://www.myworld.com) dhe mund të gjurmohet nga *Anëtari* në *Zonën e Anëtarit të Regjistruar*. *Blerjet* individuale mund të përjashtohen nga dhënia e *Shopping Points*. Numri i *Shopping Points* që kreditohen varet nga vlera e *Blerjes*, si dhe nga kushtet e caktuara nga *Kompania Partnere* përkatëse. Si bazë për llogaritjen, *myWorld* tregon numrin e *Shopping Points* që *Kompania Partnere* përkatëse jep për një çmim blerjeje prej 12.500 lekë në [www.myworld.com](http://www.myworld.com). Numri i specifikuar i *Shopping Points* mund të përdoret nga *Anëtari* në *myWorld Benefit Lounge*. *Shopping Points* nuk kanë vlerë nominale fikse. *Shopping Points* nuk mund të paguhet në para ose t'i transferohen një personi tjetër kundrejt një tarife. *Shopping Points*, të cilat mblihen nga 1.1. deri më 30.06., mund të përdoren deri më 31.12. të të njëjtit vit, përndryshe ato do të skadojnë. *Shopping Points*, të cilat mblihen nga 01.07. deri më 31.12., mund të përdoren deri më 30.06. të vitit vijues, përndryshe ato do të skadojnë.
- 6. Zona Personale e Anëtarit**
- 6.1** *myWorld* do t'i sigurojë çdo *Anëtari* *Zonën e tij Personale të Anëtarit* në [www.myworld.com](http://www.myworld.com) pa pagesë, ku *Blerjet* që janë bërë dhe informacioni në lidhje me *Benefits* nga *Benefit Program* mund të shihen në çdo kohë pasi të futen emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi. Për çdo mungesë të disponueshmërisë së faqeve të internetit të *myWorld* dhe zonës së hyrjes/kyçjes në [www.myworld.com](http://www.myworld.com), *myWorld* përgjigjet vetëm në përputhje me Klauzolën 10.
- 6.2** *Anëtari* duhet të ruajë në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale të dhënat e tij të hyrjes/kyçjes në *Zonën e tij Personale të Anëtarit* (emrin e përdoruesit, fjalëkalimin dhe PIN). Palëve të treta nuk duhet t'u jepet akses në këtë informacion. Një *Anëtar* është në gjendje të ndryshojë cilësimet e tij personale në çdo kohë në [www.myworld.com](http://www.myworld.com) (zona e hyrjes).
- 6.3** *Anëtari* merr përsipër të njoftojë menjëherë *myWorld* për çdo keqpërdorim të hyrjes/kyçjes të tij online. Pas bllokimit të menjëhershëm të hyrjes/kyçjes së tij, *Anëtari* do të marrë detajet e ndryshuara të hyrjes përmes SMS, E-mail ose me postë. *myWorld* nuk do të jetë përgjegjës për asnjë dëm që i është shkaktuar *Anëtarit* si rezultat i përdorimit jo të duhur, përveç sa parashikohet në Klauzolën 10).

## 7. Ndryshimi ose caktimi i një Rekomanduesi

*Anëtarët* mund të ndryshojnë një *Rekomandues* ekzistues në çdo kohë ose t'u caktohet një i tillë duke emëruar një *Anëtar* tjetër si *Rekomandues*. *Rekomanduesi* i sapoemëruar duhet të japë pëlqimin e tij për këtë ndryshim ose detyrë.

## 8. Mbrojtja e të Dhënave

8.1 ***Si palë përgjegjëse sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, myWorld mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna personale të tilla si të dhëna që kanë të bëjnë me zakonet e blerjes dhe Blerjet e mëparshme të Anëtarëve, për aq sa kjo është e nevojshme për të funksionuar Benefit Program, pra, llogaritja e Benefits.. Me kusht që Anëtari të ketë dhënë pëlqimin e tij, myWorld do të përdorë gjithashtu të dhënat e Anëtarëve për të personalizuar informacionet rreth ofertave dhe produkteve nga myWorld dhe Kompanitë Partnere.***

8.2 Të gjitha pyetjet në lidhje me informacionin, ndryshimin dhe fshirjen e të dhënave personale mund t'i drejtohen *myWorld Albania Shpk*, Bulevardi Bajram Curri, Galeria ETC Business Centre, Kati i 13-të, 1000 Tiranë, Shqipëri siç përcaktohet në aktet e parashikuara në Klauzolën 8.3 me poshtë.

8.3 Rregulloret e tjera mbi mbrojtjen e të dhënave personale, që lidhen me përdorimin e faqes në internet të *myWorld*, mund të gjenden në deklaratën e mbrojtjes së të dhënave në [www.myworld.com](http://www.myworld.com).

8.4 *myWorld* përdor pajisje dhe metoda sigurie të konsoliduara për të mbrojtur të dhënat e *Anëtarëve* të saj nga aksesit i paautorizuar. Përgjegjësia e *myWorld* për sigurinë e të dhënave të transmetuara në internet rregullohet nga Klauzola 10.

## 9. Përfundimi i shërbimit

9.1 Qëllimi i shërbimeve të ofruara nga *myWorld* është i kufizuar në funksionimin e *Benefit Program* siç parashikohet në Kushtet dhe Afatet e Përgjithshme të Biznesit.

Të drejtat dhe detyrimet në lidhje me *Blerjet* e bëra nga *Anëtari* prej *Kompanive Partnere* do të zbatohen vetëm për *Kompanitë Partnere*. Pas përfundimit të një kontrate me një *Kompani Partnere*, *myWorld* nuk mban asnjë detyrim ose përgjegjësi mbi garancinë lidhur me detyrimet e shërbimit të *Kompanisë Partnere*, në veçanti lidhur me mosekzekutimin e detyrimit nga *Kompania Partnere*, plotësisht ose pjesërisht.

## 10. Përgjegjësia

10.1 Asnjë nga kushtet e kësaj kontrate nuk përjashton ose kufizon përgjegjësinë e *myWorld* kundrejt një *Anëtari*, për dëmin e shkaktuar në mënyrë të paligjshme dhe me faj. Kjo përfshin përgjegjësinë për shkaktimin e (a) vdekjes ose dëmtimit personal të shkaktuar nga pakujdesia e *myWorld* (b) mashtrimi ose keqinterpretim mashtrues (c) çdo përgjegjësi tjetër, për të cilën do të ishte e paligjshme që *myWorld* të përjashtonte ose të përpiqej të përjashtonte përgjegjësinë e tij, përfshirë shkëlqen e të drejtave ligjore të një *Anëtari*.

10.2 *myWorld* është përgjegjës për humbjen dhe dëmtimin e pësuar nga një *Anëtar* që vjen si rezultat i dëmit të shkaktuar nga *myWorld* për arsye të (a) prishjes së kontratës me një *Anëtar* sipas Kushteve dhe Afateve të Përgjithshme të Biznesit; ose (b) mospërdorimit të aftësive të arsyeshme mbi të cilat *Anëtari* mund të mbështetet në mënyrë të arsyeshme. *myWorld* nuk është përgjegjës për humbje ose dëmtime që nuk janë shkaktuar.

10.3 Çdo pretendim tjetër për dëmet përjashtohet, përveç sa parashikohet në Klauzolën 10.5 më poshtë, *myWorld* nuk është përgjegjës për humbjet ose dëmtimet pa faj që vijnë si rezultat i:

- ndërprerjes të aksesit në internet të një *Anëtari*
- çështje të tjera teknike dhe elektronike (i) gjatë shkëmbimit të të dhënave në internet ose (ii) gjatë përdorimit të portalit në internet të *myWorld*, shërbimet SMS *myWorld* dhe aplikacioneve të *myWorld* për pajisjet e telefonisë së lëvizshme, me kusht që *myWorld* nuk është përgjegjës për këto çështje
- çështje teknike dhe elektronike për të cilat *myWorld* nuk është përgjegjës dhe që pengojnë regjistrimin e *Blerjeve* (në veçanti gabimet e gjurmimit dhe humbja e të dhënave që rezultojnë prej tij)
- mungesës së disponueshmërisë së rrjeteve ose stacioneve të telefonisë së lëvizshme
- defekteve funksionale në pajisjen e telefonisë së lëvizshme të një *Anëtari*

Marrëdhënia kontraktuale që rezulton nga një *Blerje*, ekziston ekskluzivisht midis *Anëtarit* dhe *Kompanisë Partnere* në fjalë. Për më tepër, *myWorld* nuk pranon asnjë përgjegjësi dhe nuk do të jetë përgjegjëse kundrejt një *Anëtari* për moskryerjen për çfarëdo arsyeje të një *Kompanie Partnere* të shitjes ose furnizimit të mallrave ose shërbimeve të kërkuara nga *Anëtari*.

10.4 Për aq sa përgjegjësia e *myWorld* është e kufizuar ose e përjashtuar, këto kufizime ose përjashtime do të zbatohen gjithashtu për përgjegjësinë personale të punonjësve, përfaqësuesve ligjorë, agjentëve dhe nën-kontraktorëve të *myWorld*.

- 10.5** Kufizimet dhe përjashtimet e përgjegjësive sipas kësaj Klauzole në asnjë mënyrë nuk ndikojnë në përgjegjësinë e *myWorld* në përputhje me detyrimet e tij sipas legjislacionit për Mbrojtjen e Konsumatorit. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Kushtet dhe Afatet e Përgjithshme të Biznesit, dhe posaçërisht në Klauzolën 10.1, përgjegjësia e *myWorld* do të kufizohet në një shumë të barabartë me dhjetëfishin e shumës së *Cashback* të grumbulluar nga *Anëtari* në periudhën gjashtëmuajore që i paraprin shkeljes së kontratës.
- 11. Zgjidhja e kontratës nga Anëtari**
- 11.1** *Anëtari* ka të drejtë të përfundojë marrëdhënien e tij kontraktuale me *myWorld* në çdo kohë. Kontrata duhet të zgjidhet me shkrim. Megjithatë në kuadrin e marrëdhënies kontraktuale të vazhdueshme, *Anëtari* nuk është i detyruar të kryejë *Blerje* ose të kryejë aktivitete të tjera.
- 11.2** Me zgjidhjen e kontratës nga *Anëtari*, ai ka të drejtë të marrë ato *Benefits* nga *Benefit Program* për të cilat përfitimi ishte vendosur në kohën kur përfundoi kontrata, që do të thotë se nëse *Blerja* që i jep të drejtën e *Cashback* tashmë është kryer në kohën kur kontrata ka përfunduar. Të gjitha *Shopping Points* të grumbulluara do të humbasin me përfundimin e kontratës. Sidoqoftë, nëse *Anëtari* do të përfundojë kontratën për shkak të një shkelje materiale nga *myWorld*, *Anëtari* do të mund të shkëmbejë çdo *Shopping Point* siç përshkruhet në Klauzolën 5 brenda një periudhe prej tetë javësh pas përfundimit të kontratës.
- 12. Zgjidhja e kontratës nga myWorld**
- 12.1** *myWorld* ka të drejtë të zgjidhë marrëdhënien kontraktuale pa shkak kundrejt njoftimit prej 30 ditësh ose zgjidhjes së kontratës me efekt të menjëhershëm me arsye të justifikuar. Arsye e justifikuar i referohet dëmtimit thelbësor të interesave ose reputacionit ekonomik të *myWorld* ose të një *Kompanie Partnere* dhe një shkelje materiale të detyrimeve kontraktuale të *Anëtarit*. Detyrimet materiale kontraktuale të *Anëtarit* përfshijnë ato të përcaktuara në Klauzolat 2.2, 2.3.
- 12.2** *Anëtari* do të dëmshpërblejë *myWorld* në rast të shkeljes me faj të këtyre dispozitave. Kjo vlen edhe për kostot e përfaqësuesit ligjor nga pretendime të palëve të treta. Gjithashtu, *myWorld* ka të drejtë të ngrejë çdo pretendim kundër *Anëtarit* që rezulton nga shkelja e detyrimeve të *Anëtarit*, duke përfshirë pretendimet për shpenzimet ligjore.
- 12.3** Me zgjidhjen e kontratës nga *myWorld*, një *Anëtar* ka të drejtë të marrë ato *Benefits* nga *Benefit Program* për të cilat përfitimi ishte vendosur në kohën kur përfundoi kontrata, që do të thotë se nëse *Blerja* që i jep të drejtën e *Cashback* tashmë është kryer në kohën kur kontrata ka përfunduar.
- 12.4** Nëse *myWorld* zgjidh kontratën për arsye të justifikuar, kur *Anëtari* nuk ka faj, *Anëtari* mund të shkëmbejë çdo *Shopping Point* siç përshkruhet në Klauzolën 5 brenda një periudhe prej tetë javësh pas përfundimit të kontratës. Përndryshe çdo *Shopping Point* do të humbasë me përfundimin e kontratës.
- 13. Dispozitat e Përgjithshme**
- 13.1** *Anëtari*, pa miratimin paraprak me shkrim të *myWorld*, nuk mund të transferojë këtë marrëveshje të lidhur me *myWorld* dhe as nuk mund të ngarkojë me barrë të drejtat ose detyrimet që lindin nga pjesëmarrja në *Benefit Program* nuk mund të përdoren si siguri.
- 13.2** Pjesëmarrja nga një *Anëtar* në *Benefit Program* përbën vetëm një marrëdhënie kontraktuale midis palëve; nuk ka asnjë marrëdhënie biznesi midis *Anëtarit* dhe *myWorld*.
- 13.3** Marrëveshjet individuale gjithmonë kanë përparësi mbi këto Kushte dhe Afate të Përgjithshme të Biznesit. Të gjitha marrëveshjet e tilla duhet të bëhen me shkrim ose të konfirmohen me shkrim nga *myWorld*. Kuptohet se palët nuk kanë lidhur asnjë marrëveshje verbale. *myWorld* ka të drejtë më tej të dërgojë çdo deklaratë kontraktuale dhe informacion të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës tek *Anëtari* me mesazh ose email, me kusht që *Anëtari* të ketë dhënë detajet përkatëse të kontaktit dhe të mos kundërshtojë këtë.
- 13.4** Ndryshimet në Kushtet dhe Afatet e Përgjithshme të Biznesit dhe marrëveshjet e tjera kontraktuale midis *Anëtarit* dhe *myWorld* duhet t'i njoftohen *Anëtarit* me shkrim. *Anëtari* do të konsiderohet se i ka pranuar ato nëse nuk i kundërshton brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të ndryshimit. *myWorld* do t'ia theksojë këtë fakt *Anëtarit* gjatë dhënies së njoftimit të ndryshimit. Ndryshimet në Kushtet dhe Afatet e Përgjithshme të Biznesit konsiderohen të pranuar nga *Anëtari* vetëm nëse njoftimi me shkrim është dhënë.
- 13.5** Fjalët në njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas. Një referencë për një gjini përfshin edhe referencën për gjininë tjetër.
- 13.6** Nëse ndonjë dispozitë e Kushteve dhe Afateve të Përgjithshme të Biznesit është plotësisht ose pjesërisht e pavlefshme ose e parealizueshme, vlefshmëria e dispozitave të mbetura nuk do të ndikohet.
- 13.7** Kushtet dhe Afatet e Përgjithshme të Biznesit do të zbatohen dhe interpretohen në përputhje me ligjin e Republikës së Shqipërisë. Konventa e Kombeve të Bashkuara për Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave nuk zbatohet.
- 13.8** Një *Anëtar* duhet të ketë mbushur tetëmbëdhjetë vjeç në mënyrë që të regjistrohet dhe të marrë pjesë në *Benefit Program*.
- 13.9** Një *Anëtar* është përgjegjës për të gjitha pagesat, tarifatat, taksat etj. e aplikueshme si rezultat i marrjes së *Benefits*.

## **Shtojca 1**

### **Përkufizimi i Termave**

"**Anëtarë**" janë të gjithë personat fizikë ose personat juridikë që kanë lidhur një kontratë me *myWorld* për lidhjen e një anëtarësimi në përputhje me Kushtet dhe Afatet e Përgjithshme të Biznesit dhe qëndrojnë si të tillë deri në përfundimin e kontratës.

"**Blerjet**" janë blerjet e mallrave, shërbimeve, udhëtimeve, etj në *myWorld* dhe te *Kompanitë Partnere*.

"**Kompanitë Partnere**" janë kompani që kanë një marrëdhënie kontraktuale me *myWorld* dhe nga të cilët *Anëtarët* mund të marrin *Benefits* në *Benefit Program* duke blerë mallra, shërbime, udhëtime, etj.

"**Benefits**" janë të gjitha përfitimet që *Anëtari* merr ose ka të drejtë të marrë duke bërë një *Blerje* në *Benefit Program*. *Benefits* në këtë kontekst mund të jenë *Cashback*, *Shopping Points* dhe promovime të tjera.

"**Benefit Program**" është programi i operuar nga *myWorld* që u mundëson *Anëtarëve* të marrin përfitime duke blerë mallra, shërbime, udhëtime, etj në *myWorld* dhe *Kompanitë Partnere*.

"**myWorld Card**" është e disponueshme si një kartë plastike ose si kartë virtuale (në internet). Nuk është një mjet pagese, por shërben vetëm për të regjistruar të dhënat e blerjes.

"**ID e Anëtarit**" është një numër unik i akorduar nga *myWorld* që shërben për të identifikuar *Anëtarin* dhe për të regjistruar *Blerjet* në *myWorld* dhe *Kompanitë Partnere*.

"**Cashback**" është *Benefit* i përshkruar më hollësisht në Klauzolën 5.

"**Shopping Points**" janë *Benefits* të përshkruara më hollësisht në Klauzolën 5.

"**Zona e anëtarit të regjistruar**" ose "**Zona personale e anëtarit**" është zona e hyrjes/kyçjes së *Anëtarit* përkatës përshkruar më hollësisht në pikën 6 në faqet e internetit të *myWorld* ([www.myworld.com](http://www.myworld.com)).

"**Rekomanduesi**" është një *Anëtar* (*Kompani Partnere*, partner bashkëpunimi, etj.) i cili ka rekomanduar një *Anëtar* tjetër ose i cili është shënuar nga *myWorld* si rekomandues i *Anëtarit* përkatës sipas njëres prej kërkesave të pikës 7.